



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:059622

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05541471

KPPP.nr.576/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimit “Sigkos” SH.A., me NUI: 811292979, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “GHM Company” SH.P.K., me NUI: 810253948, me seli në rr. “Adem Jashari”, në Gllogoc, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.312/23 të datës 14.03.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 03.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “GHM Company” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.312/23 të datës 14.03.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.312/23 të datës 14.03.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimit “Sigkos” SH.A., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.312/23 të datës 14.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. R06134/21 të datës 10.11.2022; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit

shumën në vlerë prej 6,000.00 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtu që të gjitha detyrimet duhet të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përbarimore të zbatoj përbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar ndër të tjerash se e kanë njoftuar kreditorin rreth padisë të dorëzuar në gjykatë kundër KEK-ut dhe se kreditori nuk është dashur që t'i ekzekutoj mjetet pasi që në kërkesëpadinë e dorëzuar janë arsyetuar në detaje vonesat për furnizimet sipas kontratës së nënshkruar. Më tutje ka theksuar se KEK-u ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e afatit për liferimin e mallrave dhe ka kërkuar që të gjendet ndonjë mundësi për futjen në kufi të produkteve pasiqë janë të domosdoshme për të, përkundër që ka qenë situata e pandemisë dhe transporti i mallrave ka qenë i vështirë. Meqenëse debitori është në procedurë gjyqësore me kompaninë KEK, ka kërkuar nga kreditori që të mos lejohet dhe të pezullohet ekzekutimi i sigurimit të kontratës dhe deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, ashtuqë ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e refuzuar urdhrin për përbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se Autoriteti kontraktues “KEK” ka bërë kërkesë për konfiskimin e garancionit me datë 18.02.2022, ndërsa padia nga ana e debitorit është ushtruar me datën 24.02.2022, ashtu që sipas kërkesës së autoritetit kontraktues janë plotësuar të gjitha kushtet e Policës së garancionit për konfiskim të saj, pasiqë debitori ka dështuar në përmbushjen e kontratës. Më tutje ka shtuar se pas lidhjes së sigurimit sipas polices të lëshuar nga kreditori e njëjta ka lëshuar edhe faturën e lartcekur për regresin e mjeteve konform marrëveshjes nga debitori në vlerë prej 17,950.00 €, e që kjo faturë është nënshkruar edhe nga debitori, duke paguar edhe këstin e parë sipas marrëveshjes. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. R06134/21 e datës 10.11.2022 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. R06134/21 të datës 10.11.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat janë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, kërkesa është bërë e arritshme për periudhën për të cilën kërkohet detyrimi sipas propozimit për përmbartim, si dhe është përcaktuar që në bazë të këtij dokumenti, palët me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt mund të kërkojnë përmbartimin tek përmbartuesi privat.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në neni 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të

besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.576/23, datë 03.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.